

**VENDIM**  
**Nr.307, datë 16.4.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E  
NDËRTIMIT DHE TË RIKONSTRUKSIONIT TË INFRASTRUKTURËS  
PUBLIKE, NË ZONAT E REJA TË SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR**  
*(ndryshuar me VKM nr. 337, datë 23.4.2020<sup>1</sup> nr. 375, datë 6.5.2020, nr. 761, datë 23.9.2020, nr. 937,  
datë 25.11.2020; nr. 1133, datë 24.12.2020; nr. 128, datë 3.3.2021; nr. 425, datë 8.7.2021; nr. 481, datë  
30.7.2021)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të nenit 16, dhe të nenit 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 13 180 466 653 (trembëdhjetë miliardë e njëqind e tetëdhjetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Tiranë, Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t’u kalojë njësive zbatuese, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në masën 4 770 482 221 (katër miliardë e shtatëqind e shtatëdhjetë milionë e katërqind e tetëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e një) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

b) Bashkisë Tiranë, në masën 8 409 984 432 (tetë miliardë e katërqind e nëntë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.

3. Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë në masën 1 863 461 542 (një miliard e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi në masën 1 363 461 542 (një miliard e treqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e dy) lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.

3.1 Përdorimi i fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2021, do të jetë në masën 1 611 987 454 (një miliard e gjashtëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 1 177 622 177 (një miliard e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e njëzet e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e shtatë)

---

<sup>1</sup> Ndryshuar titulli

*lekë pa TVSH, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në bashkitë Durrës, Kamzë, Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Mirditë, Shijak e Vorë.*

*b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi prej 434 365 277 (katërqind e tridhjetë e katër milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e shtatë) lekësh, pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e ndërtimit dhe të rikonstruksionit të infrastrukturës publike, në zonat e reja të shpallura për zhvillim, në Bashkinë Tiranë.*

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” të buxhetit të shtetit, sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**